



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 9

Prishtinë, më 8 qershor 2011, në orën 11: 00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Sasha Gjokiq, Flora Brovina, Salihe Mustafa, Bahri Thaçi, Aurora Bakalli dhe Gëzim Kelmendi, Nazane Breca

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj - administratore e Komisionit, Enis Halimi – zyrtar i fushës për shëndetësi, Shefki Kastrati- NDI, Ukë Gashi- Presidenca e Kosovës.

Të njëjtën e kryesoi: Fikrim Damka, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të datës 18.05.2011,
3. Raportimi i grupeve punuese për projektligjet që janë në procedurë,
4. Miratimi i listës së ekspertëve,
5. Të ndryshme.

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1.Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të datës 18.05. 2011

Kryesuesi konstatoi se Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale e miratoi procesverbalin e datës 18 maj 2011

3. Raportimi i grupeve punuese për projektligjet që janë në procedurë

Fikrim Damka- tha se Komisioni më 18 maj 2011 ka formuar dy grupe punuese për shqyrtimin e dy projektligjeve: Projektligjin për Këshillin Ekonomik-Social dhe Projektligjin për Organizimin Sindikal.

Salihe Mustafa- tha se grupi punues për Projektligjin për Organizimin Sindikal ka mbajtur dy takime. Në takimin e parë kemi biseduar rreth planit të punës. Jemi dakorduar që të mbajmë një tryezë me palët e interesuara për këtë projektligj. Në takimin e dytë, kemi propozuar datën e mbajtjes së kësaj tryeze, më 14 qershor 2011. kemi vendosur që t'i ftojme përfaqësuesit nga BSPK, KSLK, SBASHK, FSSHK, Oda Ekonomike, AKB, kryetarin e sindikatës së shërbyesve civilë, sindikatën e grave, sindikatën e punëtorëve në sektorin privat, përfaqësuesit nga Ministria e punës.

Nazane Breca- tha se në mbledhjet tona kemi propozuar disa ekspertë të cilët do të na ndihmonin neve si Komision në punën tonë.

Aurora Bakalli- theksoi se kemi pasur dy mbledhje të grupit punues: Në mbledhjen e parë, jemi takuar në një tryezë me përfaqësuesit e sindikatave, punëdhënësve dhe përfaqësuesit nga Ministria e Punës. Në mbledhjen e dytë të grupit, kemi hartuar amendamentet dhe tani jemi në fazën përfundimtare.

Gëzim Kelmendi- tha se kam propozuar që si anëtarë të KES-it të jenë edhe përfaqësuesit nga shoqata e pensionistëve.

4. Miratimi i listës së ekspertëve

Fikrim Damka- tha se keni marrë një listë të ekspertëve të propozuar. Mund të jepni edhe ndonjë propozim shtesë për këtë listë të ekspertëve.

Salihe Mustafa- tha se lista e ekspertëve duhet të jetë sa më e zgjeruar, në mënyrë që ta kemi më të lehtë në të ardhmen për angazhimin e tyre. Kam tri propozime për këtë listë: Xhafer Xhaferi, sociolog, Hevzi Matoshi, jurist, Mursel Zymberi, jurist.

Time Kadriaj- tha se është mirë të analizohet lista e këtyre kuadrove në hollësi.

Nazane Breca- tha se propozoi: Armend Shkoza, jurist, Blerim Deliaj, specialist i audiometrisë, Xhef Foks, ekspert i politikave sociale.

Bahri Thaçi- tha se propozoj që në këtë listë të përfshihet Genc Ymerhalili, udhëheqës i Qendrës për Zhvillimin e Mjekësisë Familjare.

Salihe Mustafa- tha se sot duhet ta përzgjedhim ekspertin që do të na ndihmojë në Projektligjin për Organizimin Sindikal. Propozoj Hevzi Matoshin.

Nazane Breca- tha se propozoj Armend Shkozën.

Aurora Bakalli- tha se propozoj Valon Muratin.

Pas votimit, Komisioni vendosi që, për Projektligjin për Organizimin Sindikal, në cilësinë e ekspertit, të angazhojë Armend Shkozën.

Salihe Mustafa- tha se duhet të kemi parasysh se a mos ka konflikt interesi të këtyre ekspertëve rreth angazhimit të tyre për ndihmë në këto projektligje.

Flora Brovina- tha se duhet të jemi racional në shpenzimin e buxhetit të Komisionit për angazhimin e këtyre ekspertëve, sepse kemi edhe ligje të tjera që do na vijnë dhe atëherë do të kemi nevojë për më shumë ekspertizë.

5. Të ndryshme

Fikrim Damka- propozoi që, për mbledhjen e javës së ardhshme, të ftohet ministri i Minsitrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, për të diskutuar për projektligjet që do të vijnë dhe për vizitën tonë në Institutin Special në Shtime. Kemi edhe një kërkesë nga Komisioni për Legjislacion në lidhje me një kërkesë të Avokatit të Popullit për nenin 56 të Ligjit të Punës dhe nenit 3 të Ligjit për festat zyrtare. Pra, ata kanë kërkuar nga ne interpretim për nenet e ligjeve në fjalë.

Flora Brovina- tha se ne nuk jemi ata që e bëjmë interpretimin e ligjeve dhe këto ankesa duhet të drejtohen në adresa të duhura.

Gëzim Kelmendi- tha se Ligji për akcizën e duhanit është në procedurë. Do të ishte mirë që ne si Komision të nxjerrim një rekomandim për rritjen e akcizës së duhanit dhe një përqindje e kësaj akcize të destinohet për shëndetësi.

Salihe Mustafa- tha se, për harmonizimin e Ligjit për duhanin dhe atij për akcizën e duhanit, kam dhënë propozim edhe në mbledhje të Kuvendit, sepse disa nene bien ndesh në mes veti. Sipas informatave, është vështirë që të mund të destinohet për shëndetësinë, meqë buxheti është unik.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka